

FOLLOW 80 WG

PRODUKT PER MBROJTJEN E BIMEVE



KUJDES

Fungicid me veprim kontakti dhe efekt parambrojtes duke formuar një barrierë mbrojtëse në sipërfaqen e bimës, për kontrollin e shume semundjeve kerpudhore te kulturave bujqesore.

Mekanizmi veprimit: **FRAC M4.**

Folpet është një fungicid me veprim te shumefishte nga familja e ftalimideve dhe pjesë e grupit FRAC M4.

Nuk ka rezistencë të njohur ndaj Folpet i cili vepron në tre nivele të micelit:

Ndarja qelizore: Folpet vepron në bërthamat e qelizave të sëmura duke ndërprerë ndarjen e qelizave dhe duke penguar rritjen e sporeve.

Frymëmarrja: Folpet ndërhyr në prodhimin e energjisë në mitokondri. Ai lidhet me enzimën përgjegjëse për prodhimin e energjisë dhe rritjen e sëmundjeve dhe bllokon atë aktivitet.

Përshkueshmëria qelizore: Folpet punon për të shkatërruar muret qelizore të sëmundjeve, duke ndaluar zhvillimin e qelizave.

Lenda vepruese: *Folpet 800 g/kg (80%);*

Formulimi: *Granula te tretshme ne uje (WG).*

Deklaratat e rrezikut:

H319 - Shkakton acarim serioz të syve.

H332 - I dëmshëm nëse thithet.

H351 - Dyshohet se shkakton kancer.

H400 - Shumë toksik për jetën ujore.

EUH401- Për të shmangur rreziqet për shëndetin e njeriut dhe mjedisin, zbatoni udhëzimet e përdorimit.

EUH208- Përmban folpet. Mund të shkaktojë reaksion alergjik.

Deklarata paraprake:

P261- Shmangni thithjen e pluhurit/sperkatjes.

P280- Vishni doreza mbrojtëse, veshje mbrojtëse, mbrojtje për sytë/fytyrën.

P304+P340- Nese thithet: Nxirreni personin në ajër të pastër dhe mbajeni të pushojë në një pozicion të rehatshëm për të marrë frymë.

P305+P351+P338- Nese bie ne sy: Shpëlajeni me kujdes me ujë për disa minuta. Hiqni lentet e kontaktit, nëse i keni dhe është e lehtë ta hiqni. Vazhdoni shpëlarjen.

P308+P313- Nese ekspozoheni ose jeni të shqetësuar: Kërkoni këshilla/ndihmë mjekësore.

P391- Mblidhni derdhjen.

P501- Hidhni përmbajtjen/enën në pikën e grumbullimit të mbeturinave të rrezikshme.

SP1- Mos e ndotni ujin me produktin e mbrojtjes së bimëve ose paketimin e tij. (Mos i pastroni pajisjet ose pjesët e tyre pranë ujërave sipërfaqësore. Shmangni ndotjen nëpërmjet tubave të ujit në fermë ose në rrugë).

SPe3- Për të mbrojtur organizmat ujorë, mbani një zonë sigurie të patrajtuar, me bimësi 20 m larg ujërave sipërfaqësore.

SPo2- Të gjitha veshjet mbrojtëse duhet të lahen pas përdorimit.

Udhëzime për ndihmen e pare dhe keshilla për mjekun:

Në rast kontakti me lëkurën, lëkura duhet të pastrohet me shumë ujë dhe sapun.

Në rast kontakti me sytë, shpëlani sytë menjëherë me shumë ujë për të paktën 15-20 minuta.

Në rast gjëlltitjeje, nëse personi i lënduar është i vetëdijshëm, shpëlani gojën me ujë, jepini një ose dy gota ujë për të pirë dhe ofroni kujdes mjekësor.

Terapia: trajtim vëzhgues simptomatik.

Antidot: nuk ka antidot specifik.

Perdorimi:

Në hardhi, për kontrollin e vrugut (*Plasmopara viticola*), kalbezimit gri (*Botrytis cinerea*), kalbezimit të zi (*Guignardia bidwelli*), kancerit të hardhise (*Phomosis spp.*), njollosjes së kuqe të gjetheve (*Pseudopeziza tracheiphila*). Perdorimi në fillim të lulezimit ndikon shumë mirë për lidhjen e frutave (pllenimin) si dhe për një zhvillim të mirë vegjetativ.

Në pemet frutore: kunder kromave (*Venturia inequalis* & *V. pirina*), alternaries (*Alternaria spp.*), kalbezimit të zi (*Glomerella cingulata*), gjethe perdedhese (*Taphrina deformans*), antraknozave (*Gleosporium fructigenum*), ndryshkut (*Tranzshelia discolor*), etj.

Në patate, perime (domate, kungullore), bime zbukuruese, për kontrollin e vrugjeve të familjes Peronosporaceae, si dhe të sëmundjeve të tjera si: kalbëzimet (*Botrytis spp.*), antraknozë, Cladospora, Colletotrichum, Septoria spp., alternaria (*Alternaria spp.*).

Në ulli, për kontrollin e *Spilocaea oleagina*.

Në kulturat e mesiperme perdoret me 1.5-1.8 kg preparat/ha ose me 150-180 gr preparat/100 lit ujë. Kryhen deri 6 trajtime/sezon me interval 7-10 dite.

Vërejtje për përdorimin:

Tek rrushi për verë të ndërpriten trajtimet 28 ditë para vjeljes, për të mos penguar fermentimin e mushtit.

Fitotoksiciteti:

Tek rrushi i tavolinës, para se të bëhet përzierje me preparate të tjera, të verifikohet selektiviteti në bimë të kufizuara. Spërkatjet me vajra minarale nuk duhet të kryhen pa kaluar 30 ditë nga trajtimi me folpet.

Ndikimi në mjedis:

Mesatarisht helmues për gjitarët. Pak helmues për zogjtë. Pak helmues për bletët. Mesatarisht helmues për peshqit. Mesatarisht helmues për jovertebrorët ujorë. Mos ndotni ujrat me preparatin ose me ambalazhin e tij.

Karenca:

7 ditë për domaten; 21 ditë për kungulloret; 28 ditë për rrushin; 120 ditë për ullirin.

Magazinimi:

Ruhet në vende të thata, në temperatura jo më e ulët se -10°C dhe jo më e lartë se 35°C.

Nr dhe data e regjistrimit: 596/1; 5.11.2025;

Sasia neto e PMB-se, që ndodhet në ambalazhin baze: deri 1 kg.

Data e prodhimit ;

Data e skadencës ose periudha e ruajtjes (sipas kërkesëve të përcaktuara): 3 vjet;

Numri i partise së mallit (serise) ose shenja të tjera identifikuese ;

Tipi i ambalazhit baze: Material i papershkueshem nga lageshtia (HDPE);

Emri dhe adresa e Aplikantit: Sharda Cropchem Espana S.L Adresa: Murcia, Spanje.

Emri dhe adresa e fabrikuesit të PMB-se: Sharda Cropchem Ltd. Adresa: Mumbai, India.

Emri dhe adresa e ambalazhuesit (kur ambalazhi kryhet në Republikën e Shqipërisë): Shëgjaj AGR sh.p.k.

Adresa: Dobrac, Shkoder.